



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 13

Datë: 11. 03. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KQZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
2. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 12/2024**
3. **Aktivitetet e SKQZ**
4. **Raport i Këshillave të KQZ:**

4.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për shkurtimit të afateve të rregullta zgjedhore, për votimim për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të aktiviteteve për procesin e votimit për largimin e kryetarëve të komunave;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të informimit publik;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit të vëzhgimit të zgjedhjeve;
5. Njoftim lidhur me Raportin e plotësuar të verifikimi të nënshkrimeve të peticionit;

4.2.Këshilli për Buxhet dhe Financa

- Shqyrtimi dhe miratimi i planit të buxhetit për procesin e votimit për largimin e kryetarëve në komunat: Laposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut;

4.3. Këshilli për Personel

- Shqyrtimi dhe miratimi i angazhimit të stafit jo permanente për procesin e votimit për largimin e kryetarëve në komunat: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut;

Të ndryshme !

1. Hyrie: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari **Radoniqi**, konstatoi pjesëmarrjen e anëtarëve dhe, paraqiti agjendën e takimit. **Alban Krasniqi**, mbasi që i dha arsyt rreth angazhimit - rekrutimit të stafit jo permanent në KQZ pasqi që kjo është shqyrtuar dhe rekomanduar, kërkoi që te “Këshilli i personelit” të shtohet pika: “Plotësim – ndryshimi i rregullores për pranimin e stafit të përkohshëm të zgjedhjeve në KQZ”. Në pikën “Këshilli i Operacioneve Zgjedhore”, u mënjana nën-pika 4: “Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit të vëzhgimit të zgjedhjeve”.

Me këto ndryshime, rendi i ditës u miratua 9 vota për, dhe 2 abstenime u miratua rendi i ditës.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 12/2024:

Lidhur me procesverbalin, **Radoniqi** kërkoi që të hiqet emri i anëtares “Gordana Llaban” meqë e njëjta, nuk ka qenë prezent në mbledhje. Procesverbali u miratua me 10 për, dhe 1 abstenim (Gordana Llaban).

3. Aktivitetet e SKQZ

Raport i Këshillave të KQZ:

Burim Ahmetaj, tha se raporti ka të bëjë me relacionet që janë me institucionet tjera. Ai, tha se auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2023, është bërë nga Zyra Kombëtare e Auditimit nga 12 shkurt, deri më 7 mars 2024. **Ekipi i ZKA, është në përgatitje të raportit të tyre.**

Sekretariati, është i obliguar me ligj që ta dërgojë në ZKA “Planin e zbatimit të rekomandimeve të ZKA”, deri më 15 mars.

Obligimet tjera në vijim e sipër, janë “Pyetësori i vetëvlerësimit 2023” (periudha: 1 mars – 31 mars); Deklarimi i rregullt vjetorë i pasurisë 2023; Korniza Afatmesme e Shpenzimeve; Hartimi i rreziqeve të Korrupsionit; Raporti vjetor i punës i KQZ (2023).

4. Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për shkurtim të afateve të rregullta zgjedhore, për votim për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024:

Alban Krasniqi, tha se KOZ ka shqyrtuar një mori dokumentesh, kryesisht lidhur me votimet e “21 Prillit”. Ai, i informoi anëtarët e KQZ lidhur me kërkesën për shkurtim i afateve të rregullta zgjedhore, dhe se “vendimi” rekomandohet në kontekst të procesit, gjë që KOZ e ka shqyrtuar dhe propozon për aprovim.

Ilir Gashi, tha se edhe ligji jepen që mund të shkurtohen afatet, por gjithë këto pika të KOZ-it të shqyrtuara, ka qenë e pamundshme të i shoh materialet. Për dokumentet që nuk i kam pa, nuk mund të votoj...

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka lidhur me këtë pikë ? Nëse jo, kush është për miratim ?

Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për dhe 2 abstenime (Ilir Gashi dhe Arianit Elshani), e miratuan Vendimit për shkurtrim të afateve të rregullta zgjedhore, për votim për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024:

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të aktiviteteve për procesin e votimit për largimin e kryetarëve të komunave:

Alban Krasniqi: Ky plan, rrjedh nga numri i paraparë i aktiviteteve që përmban afatet, procedurat e tjera që, mbarëvajtje të duhur.

Nuk pati diskutime, vërejtje, sugjerime.

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka lidhur me këtë pikë ? Nëse jo, kush është për miratim ?

Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për dhe 2 abstenime (Ilir Gashi dhe Arianit Elshani), e miratuan Planin e Aktiviteteve për votim për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024:

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të informimit publik:

Alban Krasniqi, tha se obligimi i KQZ-së, vec organizimit të procesit, është edhe informimi publik. Ne, kemi marrë planin edhe për edukim dhe informim për këtë proces.

Plani përmban specifikat, mënyrat si realizohet, ku realizohet, si plotësohet fletëvotimi, si votohet etj. Krasniqi, pas shpjegimeve të përgjithshme lidhur me këtë plan, i rekomandoi KQZ-në ta miratojë këtë plan.

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush diçka lidhur me këtë pikë ? Nëse jo, z. Radoniqi pyeti anëtarët e KQZ-së se a janë për miratimin e këtij plani ?

Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për dhe 2 abstenime (Ilir Gashi dhe Arianit Elshani), e miratuan Planin e Aktiviteteve e Informimit Publik për votim për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024

5. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i planit të buxhetit për procesin e votimit për largimin e kryetarëve në komunat: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut:

Gordana Llaban, the se këshilli ka mbajtur takimin e 6-të të këtij viti. Në takim, është shqyrtuar pakoja e planit të buxhetit të këtyre zgjedhjeve që, është: 233, 240, 0,1 euro. Ne, rekomandojmë për miratim të këtij plani.

Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për dhe 2 abstenime (Ilir Gashi dhe Arianit Elshani), e miratuan Planin e Buxhetit për votim për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024

6. Këshilli për Personel

Shqyrtimi dhe miratimi i angazhimit të stafit jo permanente për procesin e votimit për largimin e kryetarëve në komunat: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut:

Alban Krasniqi, tha se e kemi shqyrtuar këtë pikë. Pakoja e shpenzimeve, është integruar në pakon e buxhetit. Jemi dakorduar edhe për numrin e stafit ku angazhohet, ku angazhohet. Kjo pikë, nuk u votua meqë, ishe si njoftim.

Z. Krasniqi tha se, para pak ditësh, është shqyrtuar – diskutuar edhe rregullorja “plotësim – ndryshimin e rregullores për pranimin e stafit të përkohshëm të zgjedhjeve në KQZ. Disa ndryshime kanë ndodhë edhe në rregulloren e Qeverisë, dhe ne i kemi marrë disa për bazë si lehtësim për ne në KQZ, e gjithashtu edhe për rekrutimin e stafit jo permanent. Ne, kemi shqyrtuar afatet, përshtatjen e tyre, dinamikën e procedurave dhe, kjo rregullore tha z. Krasniqi, na duhet dhe kërkojmë që të miratohet...

Anëtarët e KQZ-së, me 11 vota për (në mënyrë unanime” u miratua Rregullorja për Pranimin e stafit të Përkohshëm të KQZ.

Të ndryshme !

Ilir Gashi, e ngriti çështjen mungesës së zyrtarëve komunal në 4 komunat veriore. Si do ti qasemi kësaj çështje? Kemi marrë në proceset e kaluara, kemi marrë nga komunat e tjera...! Është mirë që Sekretariati ta shohë këtë çështje, po mundemi edhe ne ta trajtojmë...

Burim Ahmetaj, tha se Sekretariati do ta shqyrtoj këtë situatë... !